



Prishtinë: 18.09.2008

Kodi i ZRRE-së: V_121_2008

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_117_09_08

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë dhe procedurat e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: ZRRE/DMK_R_117_09_08; dhe
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë.

Në mbledhjen e mbajtur më 18 gusht 2008 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET pjesërisht ankesa e konsumatorit Fadil Rexhepi (shifra e konsumatorit DPR – 90020715) nga fshati Tenezhdoll - Prishtinë, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK në ZRRE me datë 18.04.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK – Divizionit të Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 07.04.2008, lidhur me ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.

- Me datë 08.03.2008 ekipi i kontrollës së KEK-ut ka dalur në vendin e ngjarjes tek konsumatori dhe ka përpiluar procesverbalin nr. 0119487 në të cilin është theksuar se konsumatori posedon njehsorin elektrik të palajmëruar në KEK dhe se ka dy ura të tensionit të larguara.

Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0119487

- Me date 13.03.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar në vlerë 8,444.77 €.

Provë: Fatura e KEK-ut DPRHP05032 e datës 13.03.2008

- Me datë 28.03.2008 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar.

Provë: Ankesa e konsumatorit në KEK



- Me datë 07.04.2008 Departamenti për konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesin e kontrollës nr. 0119487.

Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 07.04.2008

- Me datë 18.04.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.

Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut ka vërejtur se:

- ✓ Sipas procesverbalit të KEK-ut nr. 0119487 vërehet se konsumatori posedon njehsor elektrik i cili njehsor nuk është lajmëruar në KEK dhe se dy urat e tensionit "S" dh "T" janë të larguara, me largimin e urave të tensionit është pamundësuar regjistrimi i energjisë elektrike për 66 %. **Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 0119487 i datës 08.03.2008

- ✓ Sipas listave të leximit të periudhës 09 dhe 10/2007 vërehet se në listën e leximit të muajit 09/2007 tek hapësira e numrit të njehsorit është shënuar njehsori me nr. 37397560 si dhe është shënuar se blloba është në rregull. Ndërsa në muajin 10/2007 vërehet se mbi hapësirën e numrit të njehsorit është shënuar numri i njehsorit të ri 44143936 cili numër i njehsorit është shënuar edhe në procesverbalin nr.0119487 si njehsor i palajmëruar.

Provë: Listat e leximit të KEK-ut të periudhës 09/2007 dhe 10/2007

- ✓ Konsumatori e ka si dëshmi edhe faturën kur edhe është blerë njehsori elektrik nr. 44143936, e cila faturë është e datës 15.10.2007.

Provë: Fatura e datës 15.10.2007

- ✓ Me rastin e ndërrimit të njehsorit dhe mos lajmërimit të ndërrimit të njehsorit në KEK me kohë konsumatori ka bërë shkelje të rregullave dhe ligjeve në fuqi.

- ✓ KEK-u ka pasur të drejtë ta ngarkoj konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar duke u bazuar në procesin e kontrollës për njehsor elektrik të palajmëruar dhe urat të tensionit të larguara.

- ✓ KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar duke u kthyer mbrapa 24 muaj që nga data e inspektimit të ekipit të kontrollës.

Provë: Fatura e KEK-ut për shfrytëzim të paautorizuar DPR08HP05032

- ✓ KEK-u me rastin e llogaritjes së faturës për shfrytëzim të paautorizuar ka gabuar ngase e ka faturuar konsumatorin për 24 muaj mbrapa, përkundër faktit se ka mundur ta caktojë fillimin e konsumit të paautorizuar në bazë të listave të leximit.

- ✓ KEK-u me rastin e llogaritjes së shfrytëzimit të paautorizuar ka marrë për bazë profilin e kabllit i cili ka qenë $4 \times 10 \text{ mm}^2$ mirëpo sipas procedurës së përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike tek kapitulli i tretë theksohet se për llogaritje do të merret parametri më i vogël i verifikuar dhe se në



procesverbalin e KEK-ut nr. 0119487 të datës 08.03.2008 ekipi i KEK-ut e ka shënuar se dalja e njehsorit në siguresa është 32 A.

Provë: Llogaritja e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar dhe procesverbali i KEK-ut nr. 0119487 të datës 08.03.2008

- ✓ KEK-u në rastin e konsumatorit nuk ka gabuar në vlerësim të shfrytëzimit të paautorizuar por ka gabuar në përcaktimin e periudhës së shfrytëzimit të paautorizuar.

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmime të paraqitura, i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë pjesërisht** ankesën e konsumatorit:

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta pranojë ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së. Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. KEK-u obligohet që menjëherë të shkarkojë konsumatorin nga fatura DPR08HP05032 e ngarkesës për shfrytëzim të paautorizuar për 24 muaj.
2. KEK-u obligohet që të bëjë rillogaritjen për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë së konsumuar nga konsumatori, duke respektuar rregullën për shkyçje dhe rikyçje të konsumatorëve në sektorin e energjisë dhe procedurën e përkohshme për identifikimin dhe parandalimin e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike. Duke marrë parasysh se mund të caktohet koha kur ka filluar shfrytëzimi i paautorizuar i energjisë në bazë të dëshmime të paraqitura nga KEK-u dhe konsumatori.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente të Prishtinës, brenda **katërbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së:

Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Nysret Avdiu, anëtar